



Republika e Kosovës
Republika Kosovon - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit

Mbledhja nr. 06

Prishtinë, më 15.6.2015, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Armend Zemaj, Selvije Halimi, Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi dhe Danush Ademi.

Munguan: Enver Hoti dhe Milena Miliçević.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Kaltrina Ahmeti, GLPS; Floriana Shala dhe Arta Krasniqi, OSBE; Driton Selmanaj, KDI; Xheladin Hoxha, drejtor në DMKP; Blerta Bejtullahu, URSR/Office dhe Gentiana Dushi, praktikante.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Armend Zemaj, kryetar i Nënkomisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Hartimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës;
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Hartimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës

Kryetaritha se do të vazhdojmë aty ku kemi mbetur, tek imuniteti, neni 27 i projektligjit. Ai propozoi që në paragrafin e dytë të nenit 27, fjalët: “pa asnjë vonesë”, të hiqen dhe të zëvendësohen me fjalën “menjëherë”. Në këtë kontekst, u diskutua edhe për aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, që ka të bëjë me imunitetin e deputetit, në raport me dispozitën e nenit 27 të projektligjit.

Albulena Haxhiu, propozoi që në nenin 28, paragrafi 3, fjala “formal”, të hiqet.

Me propozimet e Armend Zemajt dhe Albulena Haxhiut, Nënkomisioni bëri ndryshime në nenin 29, paragrafi 5, ku hiqen fjalët “në kryerje in flagranti”, po ashtu edhe në nenin 31, paragrafi 2, fjalët “ka të drejtë të”, të hiqen. Në nenin 29, hiqen fjalët: “ose një autoritet tjetër kompetent për ndjekje penale.”

Xheladin Hoxha, propozoi që neni 32, paragrafi 3, të riformulohet si vijon: “2. Deputeti ka për detyrë dhe obligim që të marrë pjesë në punimet e Kuvendit, duke ushtruar të drejtën e tij për të votuar për, kundër dhe abstenim”.

Albulena Haxhiu, e kundërshtoi fuqishëm këtë propozim, duke thënë se kjo është e padrejtë dhe nuk mund ta detyrojë deputetin për të votuar. Nëse ky propozim kalon, atëherë unë nuk do ta votojë këtë projektligj.

Selviqe Halimi, theksoi se meqë kemi qëndrime të ndryshme, atëherë të kërkojmë nga Drejtoria për Hulumtime, ta kemi një hulumtim për këtë çështje.

Donika Kadaj- Bujupi, ishte e mendimit se duhet të gjendet një mes për ta fuqizuar rolin e Kuvendit dhe të ngritët përgjegjësia e deputetit. Ndoshta, kjo do të duhej të ishte pjesë e rregullores, jo e ligjit.

Pas diskutimeve për dhe kundër, për këtë propozim u vendos që të kërkohej nga Drejtoria për Hulumtime, që për nevojat e Nënkomisionit, ta përgatisë një hulumtim për mënyrën e votimit të deputetëve dhe detyrimet e deputetëve në mbledhjet e Kuvendit, në shtet me sistem të ngjashëm.

Nënkomisioni diskutoi edhe për nenet 33, 34 dhe 35 të projektligjit dhe u thase këto nene duhet të harmonizohet me Ligjin për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë. Nenet 33 dhe 34, të hiqen, kurse neni 35 të riformulohet si vijon: “ *Deputetët deklarojnë pasurinë sipas Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave të të gjithë zyrtarëve publikë*”.

Në nenin 39, paragrafi 1, hiqen fjalët: “pa pagesë”.

Neni 42, paragrafi 3 i projektligjit, hiqet, kurse shtohen paragrafë të rinj, duke marrë për bazë paragrafët: 2,3,4,5,6 dhe 7 të nenit 13 nga Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit.

Në fund të takimit, Nënkomisioni vendosi që kreu IV dhe IX i projektligjit, t'i dërgohet Komisionit për Buxhet dhe Financa, për komente.

3. Të ndryshme

Takimi i radhës së Nënkomisionit u caktua më 16.6.2015, në orën 12:50.

Mbledhja përfundoi në orën 10:05.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Nënkomisionit

Armend Zemaj